Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Developement

ANALIZA E TREGUT TË LAJTHISË



Shtator, 2021

Tabela e përmbajtjes

Parathënie **3**

1 Tregu i lajthisë **4**

2 Prodhimtaria Vendore **4**

3 Zhvillimi i tregtisë **5**

3.1 Importi i lajthisë 5

3.1.1 Importi i lajthisë sipas shteteve 6

3.2 Bilanci tregtar 8

4 Çmimet e lajthisë **8**

4.1 Çmimet në tregun vendor 8

4.2 Çmimet e importit 9

4.3 Çmimet për njësi të importuar 10

5 Mbështetja e prodhimtarisë së lajthisë **10**

5.1 Pagesat direkte për kulturën e lajthisë 11

5.2 Masat e zhvillimit rural që përkrahin sektorin e pemëve – lajthinë 11

6 Konkluzione **12**

Parathënie

Deri më tani, kulturat të cilat janë kultivuar më shumë në Kosovë janë ato dru-frutore si molla, kumbulla, dardha etj. dhe pemët e imëta si mjedra, dredhëza, boronica, etj., por kohën e fundit është rritur interesimi edhe për kulturat arrore si arra, lajthia etj. Lajthia deri më tani më shumë është rritur në male, por së fundi, duke marr parasysh profitabilitetin e saj, fermerët kanë nisur edhe ta kultivojnë atë.

Lajthitë konsiderohen si një nga frutat arrore më të shijshme, aromatike dhe shumë ushqyese. Ato konsumohen si frut i freskët ose i pjekur, apo mund të përdoren si përbërës në ushqime, veçanërisht në përgatitjen e brumërave të ndryshme, produkte konditorike, çokollata, drithëra, produkte të qumështit. Përveç që përdoren për konsum, lajthitë përdoren në industrinë e parfumeve, industrinë kozmetike, industrinë e ngjyrës, etj., ndërsa gjethet e lajthisë përdoren gjerësisht në mjekësinë popullore.

Analiza e tregut të lajthisë është punuar nga Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore dhe ka për qëllim të shërbej si një dokument i cili ka të përmbledhura të dhënat e përgjithshme statistikore lidhur me tregun e lajthisë në Kosovë.

Në këtë analizë paraqiten më gjerësisht të dhënat për sipërfaqen, prodhimtarinë vendore, çmimet e lajthisë, pasqyrën e eksportit dhe importit të lajthisë, madhësinë e tregut, zhvillimin e tregtisë, mbështetjen e kulturës së lajthisë si dhe konkluzionet e përgjithshme lidhur me këtë analizë.

1 Tregu i lajthisë

Edhe pse në vendin tonë kultura e lajthisë është më tepër e njohur për konsum sesa për kultivimin e saj, së fundi kjo kulturë ka zgjuar interesim tek fermerët, kultivimi i së cilës është rritur gjatë viteve të fundit. Nga viti 2015 deri në vitin 2020, sipërfaqja është rritur 6-fish kurse prodhimi ka pasur rritje 9-fish. Lajthia njihet botërisht si kulturë që mbron tokën nga erozioni, mund të lulëzojë edhe në tokë të ashpër, të thatë dhe në kushte të vështira klimatike, ku kulturat tjera nuk do t'i mbijetonin. Po ashtu, kjo kulturë edhe pse i nevojitet ujitje sidomos në vitet e para, për shkak të rrënjëve të gjata mund të mbledh ujin nga thellësia e tokës në kohë thatësire duke e bërë lajthinë kulturë mjaft të qëndrueshme. Pema e lajthisë konsiderohet edhe si mbrojtëse e ambientit, sepse gjatë prodhimit e zvogëlon emetimin e dioksidit të karbonit duke e absorbuar atë në trungun dhe rrënjët e saj.

2 Prodhimtaria vendore

Bazuar në të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), kultura e lajthisë gjatë periudhës 2016-2020 ka pasur trend rritjeje e kjo tregon që kohën e fundit ka një interesim më të madh nga fermerët për kultivimin e kësaj kulture. Nëse e krahasojmë me vitin paraprak, sipërfaqja në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019 është rritur për 55% ndërsa prodhimi për 45%. Pasi që sipërfaqja më e madhe e plantacioneve të mbjellura me lajthi janë relativisht të reja, nevojiten disa vite që kjo kulturë të hyjë në prodhim të plotë, e për këtë arsye prodhimi i lajthisë është ende i ulët. Në mënyrë që lajthia të sjellë një prodhim të mirë, duhet t'i kushtohet kujdes i veçantë zgjedhjes së varietetit, llojit të tokës (p.sh lagështia e tepërt e dëmton lajthinë), teknikës së mbjelljes, etj.

Figura 1: Sipërfaqja dhe prodhimtaria e lajthisë, 2016-2020



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës – ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

3 Zhvillimi i tregtisë

Përkundër faktit se lajthia gjithnjë e më tepër po rritet në sipërfaqe dhe prodhim, sasia më e madhe importohet nga vendet tjera. Në aspektin e tregtisë, sasia më e madhe e prodhimit të lajthisë në vend shitet në treg ndërsa pjesa e mbetur përdoret për konsum shtëpiak. Kosova ka eksportuar një sasi simbolike të lajthisë në vitin 2019 në Gjermani por kjo sasi është fare e ulët. Sa i përket importit, më së shumti lajthi është importuar nga Turqia, Maqedonia e Veriut, Greqia, Serbia, Italia, etj.

3.1 Importi i lajthisë

Gjatë periudhës 2016-2020, importi i lajthisë ka shënuar rritje të dukshme. Nga viti 2016 deri në vitin 2018, sasia e importuar e lajthisë është rritur rreth 6-fish, ndërsa në vitin 2019 dhe 2020 ka pësuar rënie. Nëse e krahasojmë vitin 2020 me vitin paraprak, ka pasur rënie për 10%. Sa i përket vlerës së importuar, vlera më e lartë gjatë periudhës 2016-2020 ishte në vitin 2019 (57,790 €) kurse në vitin 2020 ishte 21% më e ulët. Në përgjithësi, më së shumti është importuar lajthi e qëruar, kurse e paqëruar ishte importuar në vitin 2017 nga Turqia një sasi shumë e vogël, dhe në vitin 2019-2020 nga Maqedonia e Veriut në gjithsej sasi prej vetëm 3.3 tonë.

Figura 2: Importi i lajthisë sipas sasisë në kg (majtas) dhe sipas vlerës në € (djathtas)



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Figura në vijim paraqet të dhëna për vlerën e importit sipas muajve për vitin 2019 dhe 2020. Të dhënat nga kjo figurë tregojnë se në vitin 2019, vlera më e lartë e importit ishte në muajin dhjetor, tetor, korrik dhe prill, që mund të lidhet me kohën e festave në ato muaj. Në vitin 2020, vlera më e lartë ishte në muajin mars dhe tetor, ndërsa për dallim nga viti 2019, në vitin 2020 kishte rënie të importit e kjo mund të jetë si pasojë e ndikimit të Covid-19 në gjitha proceset ekonomike në mbarë botën.

Figura 3: Vlera e importit të lajthisë sipas muajve në €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

3.1.1 Importi i lajthisë sipas shteteve

Figurat më poshtë paraqesin vlerën e importit të lajthisë sipas shteteve në euro si dhe përqindjen e pjesëmarrjes së shteteve prej të cilave Kosova importon më së shumti lajthi. Bazuar në të dhënat e tregtisë, për periudhën '16-'20 rezulton se sasia më e madhe e lajthive vjen nga Turqia, pasuar nga Maqedonia e Veriut, Greqia, Italia, Serbia, Gjermania dhe shtete të tjera me më pak pjesëmarrje.

Figura 4: Vlera e importit të lajthisë sipas shteteve, në €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

Figura 5: Importi i lajthisë sipas vendeve (%)



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR

3.2 Bilanci tregtar

Vendi ynë ka bilanc tregtar negativ sa i përket lajthisë meqenëse pjesa më e madhe importohet, kurse eksport mund të themi se nuk ka, përveç një sasie fare simbolike në vitin 2019. Si rezultat, bilanci tregtar për lajthinë në vitin 2020 ishte negativ në vlerë prej 45,527 €.

4 Çmimet e lajthisë

Lajthia, për shkak të veçorive të saja ushqyese dhe përdorimit të gjerë, karakterizohet si një kulturë mjaft profitabile dhe me kërkesa të vazhdueshme ku plasimi i saj në treg nuk paraqet problem. Sasia më e madhe nga prodhimtaria e lajthisë në vendin tonë shitet në tregun vendor, ndërsa pjesa tjetër përdoret për konsum familjar.

4.1 Çmimet në tregun vendor

Në figurën më poshtë shihet se çmimi i lajthisë në fermë për lajthinë e qëruar ka pasur luhatje gjatë periudhës 2016-2020. Në vitin 2016 çmimi ishte më i larti në vlerë prej 12.4 €/kg kurse në vitin 2017 pësoi rënie të dukshme për 25%. Në vitet në vijim pati një rritje të lehtë por sërish pësoi rënie të çmimit në vitin 2020 në 9.5 €/kg. Në anën tjetër, çmimi i lajthisë së paqëruar nuk ka pasur edhe aq ndryshime, mirëpo nga viti 2016 deri në vitin 2019 ka pasur trend uljeje, ndërsa në vitin 2020 shënoi rritje të lehtë në vlerë prej 3.6 €/kg.

Figura 6: Çmimet e lajthisë së qëruar dhe paqëruar në fermë, €/kg



Burimi: Sistemi Informativ i Tregut (SIT Kosova)

Sa i përket çmimeve vendore me pakicë dhe shumicë në treg për lajthinë e qëruar dhe paqëruar, ato variuan nga viti në vit por jo me ndryshime shumë të theksuara. Mesatarja e çmimit të lajthisë në treg me pakicë për periudhën 2016-2020 për lajthinë e paqëruar ishte 4.74 €/kg kurse për lajthinë e qëruar ishte 13.2 €/kg. Mesatarja e çmimit për lajthinë e paqëruar me shumicë për periudhën 2016-2020 ishte 4.25 €/kg ndërsa 12 €/kg ishte mesatarja për lajthinë e qëruar.

Figura 7: Çmimet vendore të lajthisë së paqëruar (majtas) dhe të qëruar (djathtas) në treg, €/kg



Burimi: Sistemi Informativ i Tregut (SIT Kosova)

4.2 Çmimet e importit

Çmimet e importit të lajthisë së qëruar dhe paqëruar me shumicë dhe pakicë për periudhën '16-'20 janë paraqitur në figurën e mëposhtme. Krahasuar me vitet paraprake, në vitin 2020 çmimet e lajthisë së qëruar dhe paqëruar ishin dukshëm më të ulëta. Nëse e krahasojmë çmimin e lajthisë së paqëruar me atë të vitit 2016, rezulton se në vitin 2020 çmimi me shumicë ka rënë për 18% ndërsa ai më pakicë për 19%. Sa i përket lajthisë së qëruar, krahasuar me vitin 2016, në vitin 2020 çmimi me shumicë ishte 17% më i ulët ndërsa ai me pakicë 16% më i ulët.

Figura 8: Çmimet e importit të lajthisë së paqëruar (majtas) dhe lajthisë së qëruar (djathtas), €/kg



Burimi: Sistemi Informativ i Tregut (SIT Kosova), përpunuar nga DAESB-MBPZhR

4.3 Çmimet për njësi të importuar

Nëse analizojmë çmimet e lajthisë për njësi të importuar, bazuar në të dhënat e marra nga ASK të deklaruara nga dogana, rezulton së mesatarja për periudhën '16-'20 ishte 8.05 €/kg. Çmimi më i lartë ishte në vitin 2016 në vlerë prej 10.8 €/kg kurse ai më i ulëti në vitin 2018 (5.2 €/kg). Në vitin 2020, çmimi i lajthisë për njësi të importuar ishte 7.3 €/kg, e ky çmim është 13% më i ulët se i vitit paraprak.

Figura 9: Çmimet e lajthisë për njësi të importuar



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZhR,

5 Mbështetja e prodhimtarisë së lajthisë

Programi i pagesave direkte është ndër shtyllat kryesore të mbështetjes që jep shteti për fermerët e vendit tonë. Ndër vite ky program është zgjeruar dhe buxheti në vazhdimësi për përkrahje është rritur. Objektivat që tentohen të arrihen përmes pagesave direkte për kulturën e lajthisë janë: rritja e të hyrave në fermë, përmirësimi i konkurrencës dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor, mirëmbajtja e vazhdueshme e pemishteve ekzistuese, zvogëlimi i kostos së prodhimit, përmirësimi i cilësisë së prodhimit, rritja e rendimentit dhe intensifikimi i ekonomizimit të aktiviteteve bujqësore.

5.1 Pagesat direkte për kulturën e lajthisë

Kultivuesit e lajthisë për të përfituar nga programi i pagesave direkte duhet të kenë të mbjellura së paku 0.50 ha. Parcela e mbjellur me pemë drufrutore duhet të jetë së paku 0.20 ha e pandarë. Në rast se fermeri merr tokë me qira gjithashtu edhe sipërfaqja e marrë me qira duhet të jetë së paku 0.20 ha e pandarë, e dokumentuar përmes kontratës. Subvencionimi në formë të pagesave direkte bëhet për sipërfaqe të mbjellura me lajthi në vlerë prej 400 €/ha.

5.2 Masat e zhvillimit rural që përkrahin sektorin e pemëve – lajthinë

Në kuadër të masave të zhvillimit rural në vitin 2020, prodhimtaria e lajthisë është përkrahur në kuadër të masës 101, "Investimet në asete fizike të ekonomive bujqësore". Në momentin e aplikimit për investime në sektorin e pemëve, aplikuesit duhet të dëshmojnë se kanë sipërfaqe të tokës bujqësore në pronësi, të trashëguar apo të marrë me qira për së paku 10 vjet të llogaritur nga viti i aplikimit dhe atë së paku 1 hektar për pemë drufrutore kurse sipërfaqja minimale e ngastrës duhet të jetë 0.35 hektar; përfituesit për ngritjen e pemishteve të reja, para kërkesës për pagesë, nëse blejnë fidanë të prodhuar në Kosovë, duhet të dorëzojnë kopjen e certifikatës fito-sanitare mbi gjendjen shëndetësore të materialit fidanor që përmbush kriterin CAC (Conformitas Agraria Communitatis) dhe kopjen e licencës së prodhuesit, kurse ata që blejnë fidanë të importuar nga vendet e BE-së, duhet të dorëzojnë kopjen e certifikatës fito-sanitare mbi gjendjen shëndetësore të materialit fidanor që përmbush së paku kriterin CAC të lëshuar nga prodhuesi, certifikatën për prejardhjen e origjinës dhe lejen e importit të ndërmarrjes importuese; fidanët e mbjellur të pemëve drufrutore duhet të kenë të ngjitur në trup etiketën e institucionit certifikues.

Vlera minimale e pranueshme për projektet për pemë drufrutore është 10,000 €, ndërsa vlera maksimale është 100,000 €. Përkrahja publike është 60% e shpenzimeve të pranueshme të investimit, ndërsa përkrahje shtesë prej 5% jepet për investime në zonat malore dhe 5% për fermerë të rinj (40 vjeç ose më të rinj në momentin e aplikimit). Shuma totale e ndarë për përkrahje të pemëve drufrutore në vitin 2020 është 4,000,000 €, nga të cilat 800,000 € janë të ndara për kulturën e arrës dhe lajthisë.

Lajthia përkrahet edhe në kuadër të masës 103, Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore. Vlera minimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt është 30,000 €, ndërsa vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt është 400,000 €. Përkrahja publike është 50% e shpenzimeve të pranueshme të investimit. Buxheti i planifikuar për përpunimin e pemëve dhe perimeve në vitin 2020 ishte 2.1 mil. €.

Përveç masës 101 dhe 103, lajthia përkrahet edhe në kuadër të masës 302, Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve, gjegjësisht nënmasën 302.3 - Përpunimi i prodhimeve bujqësore në ekonomi familjare.

Vlera minimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt, për të gjitha nën masat e kësaj mase është 5,000 €, ndërsa vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për projekt për nënmasën 302.3 ishte 20,000 €. Përkrahja publike ishte 65% e shpenzimeve të pranueshme të investimit kurse përkrahje shtesë prej 5% është dhënë për investime në zonat malore.

6 Konkluzione

Nga të gjitha të dhënat e paraqitura në analizën e tregut të lajthisë mund të konkludojmë se në Kosovë në përgjithësi sipërfaqja e mbjellur me lajthi është rritur në vitet e fundit mirëpo ende është mjaft e ulët dhe si rezultat i kësaj për t'i mbuluar pjesën më të madhe të kërkesave të veta, vendi ynë importon lajthi nga shtetet tjera, posaçërisht nga Turqia. Krijimi i kushteve të avancuara për kultivimin e kulturës së lajthisë dhe rritja e sipërfaqes së mbjellur me lajthi është një ndër prioritetet e MBPZhR-së për vitet e ardhshme. Mbështetur nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë, në Graçanicë është ndërtuar fabrika për përpunimin e frutave arrore e cila shumicën e lëndës së parë e siguron nga importi pasi që prodhimi në Kosovë është shumë i ulët. Rritja e sipërfaqeve të mbjellura me lajthi dhe krijimi i zinxhirit të vlerës do të siguronin një zhvillim më të qëndrueshëm të kësaj veprimtarie. Kultivimi i lajthisë duhet të promovohet më tepër kur dihet fakti se zhvillimi i industrisë së përpunimit të lajthisë gjithashtu ndikon në rritje të punësimit dhe gjenerim të të ardhurave në zonat rurale.